

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: SABA BELCA Dega në Kosovë; SB CONSTRUCTION SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K., Rruga e Llapit, Millosheve, 15050, Obiliq Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	19.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës: **17.10.2022**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **SABA BELCA Dega në Kosovë; SB CONSTRUCTION SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K.** me adresë në **Obiliq**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **SABA BELCA Dega në Kosovë; SB CONSTRUCTION SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K.** me adresë në **Obiliq**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **12.10.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: SABA BELCA Dega në Kosovë; SB CONSTRUCTION SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K. me adresë në Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1, Numër i brendshëm: 623-22-025-5-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 12.10.2022, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 17.10.2022, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor gjithmonë është bazuar në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj: *“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë...”* Po ashtu sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, ku cekë se: *të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

Po ashtu Konform RrUOPP-së neni 41.12 citon: *“AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuar në njoftimin e kontratës/dosjes e tenderit”*

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Njoftimit për kontratë/dosjes e tenderit dhe Specifikave teknike, po ashtu është me çmim më të lirë në krahasim me oferta tjera.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

PRETENDIMI ANKIMOR NDAJ GRUPIT TË OPERATORËVE EKONOMIK TË REKOMANDUAR PËR SHPËRBLIM ME KONTRATË GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK "FAMIS CO - HC" SH.A. & NPT BAMIRS

Gjatë qasjes në dokumente kemi arritur të identifikojmë një numër të madh të kritereve të pa plotësuara nga GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK i rekomanduar për kontratë.

Pretendimi nr. 1

GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK "FAMIS CO - HC" SH.A. & NPT BAMIRS, nuk i plotëson kriteret sipas, Seksioni II. Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD), pasi që ka mungesë të dokumentacionit si në vijim:

Tek kërkesa në FTD: 8.1 & 8.2 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mbështetje nga Banka ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku 150,000.00 €	Dëshmia 2 Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.
---	---

Ky GRUP I OPERATORËVE EKONOMIK ka dorëzuar një mbështetje bankare të lëshuar nga ProCredit Bank me titull "Letër reference" në të cilën thuhet se nëse klienti "FAMIS CO-HC SHA" kërkon mbështetje financiare për projektin në fjalë atëherë ProCredit Bank do të konsiderojë mbështetjen financiare në shumën prej 150,000.00 EURO, duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar pas analizës financiare të bërë nga Këshilltarët e Klienteve për Biznes.

Pra ky dokument në asnjë formë nuk e dëshmon që OE ka mjete të gatshme në llogari, mbështetje nga banka apo akses në kredi në vlerën e kërkuar, kjo vetëm dëshmon se OE do të trajtohet sikurse të gjithë klientët e tjerë, dhe se në rast se aplikon për kredi kjo bankë do të shqyrtojë mundësinë për mbështetje gjithnjë duke u bazuar në kapacitetin financiar të bërë nga analistët e bankës.

Kjo padyshim se nënkupton, se aktualisht analistët e bankës nuk kanë bërë ndonjë analizë lidhur me kapacitetin financiar të OE dhe se nuk garantojnë se i njëjti do të ketë akses në kredi apo mbështetje nga banka. Vlen të theksohet se përgjigje të tillë të bankës mund të marrin të gjithë klientët e bankës në vlerën që ata dëshirojnë (deri 10 milion euro) dhe nuk përbën asnjë problem për bankën pasi aty ceket shumë mirë që do të konsiderojë mbështetjen bazuar në kapacitetin e tij financiar.

Në lidhje me këtë çështje i kemi shumë vendime të OSHP-së të cilat shumë mirë e paraqesin përgjigjen ndaj kësaj.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i papabuar.

Ju sqarojmë se lidhur me kriterin e kërkuar te pika 8.1 & 8.2 të FDT – së,

Kërkesa 2: *Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mbështetje nga Banka ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku: 150,000.00 €, ndërsa dëshmi dokumentare është: Dëshmia 2: Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.*

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë: "FAMIS CO - HC" SH.A, lidhur me kriterin në fjalë të FDT-se, ka të bashkangjitur Letër Referencë nga ProCredit Bankë (citim): *Nëse klienti "FAMIS CO - HC" SH.A, kërkon mbështetje financiare në emër të tenderit: NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM, me Numër të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1 nga Komuna e Rahovecit, Pro Credit Bank do të konsiderojë mbështetjen financiare në shumën prej: 150,000.00 Euro, duke u bazuar në kapacitetin e tij financiare pas analizës financiare të bërë nga Këshilltaret e Klientëve për Biznes. Dokumenti është lëshuar me datë: 07.09.2022, ndërsa Analiza financiare është qështje e brendshme e Bankës.*

Duke marr parasysh kriterin e kërkuar në Dosjen e tenderit, që kërkon garancionin bankar për realizimin e kontratës, Operatori Ekonomik ka dëshmuar me Letër Referencë....nëse i plotëson konditat e bankës dhe nëse është i suksesshëm për projektin në fjalë do të mbështesim.

Si dhe Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk gjendet në listën e zeze të FATF (Financiar Action ose Task Force).

Për këtë çështje ka Vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, PSH. Nr. 991/20; 1019/20; 1020/20; dhe 1035/20 i dt. 11.01.2021, dhe Vendimi nga Paneli Shqyrtues PSH.nr. 86, 101, 109, 114/21, dt. 12.03.2021

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pretendimi nr. 2

Ky GRUP I OPERATORËVE EKONOMIK poashtu nuk ka paraqitur dëshmitë mbi krijimin e një grupi të operatorëve ekonomik pasi nuk ka paraqitur deklaratën: d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ju si Operator Ekonomik ankues, gjatë qasjes në dokumentacionin e kërkuar nga personi i Autorizuar, keni verifikuar se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, e ka plotësuar **Deklaratën nën Betim**, dhe ka dorëzuar dokumentacionet sipas pikës 2 dhe 3 të Kërkesave të përshtatshmërisë.

Dhe pika d. thotë: *Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.*

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Pretendimi nr. 3

GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK në shtet ka dorëzuar ofertë me çmime manipulative që në terme ligjore klasifikohen si tender jo normalisht i ulët (shih pozicionin 1.4, 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.9, 7.2 tek Punët Ndërtimore-Sheshi Qendror si dhe pozicionin 2.6 tek ElektriKa-Sheshi Qendror) e që AK kundrejt të njëjtit nuk ka aplikuar dispozitat përkatëse nga neni 61 të LPP-së dhe rregullat – Rregulloren për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.
Paraqesim vetëm një shembull të aplikimit të Rregullores për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët për pozicionet e përshkruara më lartë.

Tek ky pozicion kemi: *"Furnizimi, transportimi dhe montimi i pllakave te granit, kuarc, tehe campher me dimensione 60/40cm me trashsi 10cm"* ku ky GRUP I OPERATORËVE EKONOMIK ka ofertuar me një çmim njesi 25€ për m2. Pra ky çmim nuk korresponon as për kubëza të betonit e asesi për pllaka graniti me këtë trashësi.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Operatori Ekonomik në vlerën totale te ofertës nuk e ka arritur asnjë prag për tu llogaritur oferta me çmim jo normalisht e ulët sipas B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Ndërsa sa i përket pozicionit 3.9. *Furnizimi, transportimi dhe montimi i pllakave te granit, kuarc, tehe campher me dimensione 60/40cm me trashsi 10cm.* duke pretenduar se ky pozicion është me çmim që nuk korresponon as për kubëza të betonit e asesi për pllaka graniti me këtë trashësi, ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që disa ofertuesit kemi pranuar këtë çmim për këtë pozicione:

Shih tabelën e bashkangjitur:

3.9 Furnizimi, transportimi dhe montimi i pllakave te granit, kuarc, tehe campher me dimensione 60/40cm me trashsi 10cm.		
Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Çmim për pozicion:
1.	N.P.N. HIDROTERM SH.P.K. Brigada 123, 23000, Suharekë	24.00 € m2
2.	Vehbi Mamaj B.I., Rr. Skënderbeu, p.n, 23000, Suharekë	22.00 € m2
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik: "FAMIS CO - HC" SH.A; N.P.T. "Bamirs", SUHAREKË - PRIZREN M25 SEMETISHT, 23000, SUHAREKË	25.00 € m2
4.	"FLORI" SH.P.K., Studenqan, 23000, Suharekë	35.00 € m2
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik: Infra - Plus SH.P.K.; ARLINDI SHPK, Rr. Luan Hardinaj Sol. 1 H.1, 10000, Prishtinë	27.00 € m2

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Ndërsa sa i përket Pretendimit tuaj ankimor për Operator Ekonomik:

- a. Grup i Operatorëve Ekonomik: NPN EUROING SH.P.K.; Mendi - P SH.P.K., XËRXË, 21000, RAHOVEC
- b. Grup i Operatorëve Ekonomik: Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI - BETON SH.P.K.; EAE - NJAZ SH.P.K., Rr. Arben Qerimaj, Nr. 180, 51000, Deçan

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, janë të pabazuara dhe ofertat e dorëzuar janë me çmim me te lartë se Oferta e rekomanduar për kontratë

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit